



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:111940

Datë: 17.11.2021

Numri i dokumentit: 02406829

C.nr.1278/21

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.M. nga Ferizaj të cilin e përfaqëson me autorizim av Rafiz Shehu, kundër të paditurës KS "Siguria" me seli në Prishtinë, për çështjen juridike kompensim i dëmit material, në seancën kryesore të mbajtur me dt.26.10.2021, në praninë e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurës mori, ndërsa me datë 8 nëntor 2021 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit D.M. nga Ferizaj, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura KS Siguria nga Prishtina, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar si pasoj e aksidentit të shkaktuar më datë 30.04.2020 t'ia paguaj gjithsejtë shumën prej 1,662 €, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 420 € në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në gjykatë më dt.07.06.2021 ka paraqitur padi për kompensimi ne dëmit material, me propozim për sigurimin e provës me caktimin e ekspertizës së makinerisë, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave, e

sidomos në fjalinë e fundit të ekspertizës në faqe 9 ku ndër të tjera thuhet se për kundër riparimit automjeti nuk do të ishte i sigurt për lëvizjet në komunikacion, pra konsiderohet si dëmtim total teknikisht total, andaj edhe precizimin e kërkesë padisë e kanë bërë në bazë të ekspertizës. Kërkojnë nga gjykata që padinë e paditësi ta aprovoj në tërësi si të bazuar, gjithashtu kërkojnë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme 420€ dhe atë për një seancë gjyqësore 135€, për përpilimin e padisë 104€, për ekspertizë 150€ dhe për taksë gjyqësore 31€.

E paditura nuk ka qenë prezentë në seancën gjyqësore të datës 26.10.2021, edhe pse e njëjta është ftuar për seancë gjyqësore, fillimisht e ka pranuar aktvendimin mbi përgjigjen në padi më datë 09.07.2021, ndërsa ftesën për seancën gjyqësor të datës 26 tetor 2021 dhe ekspertizën e makinerisë e ka pranuar më datë 07.09.2021.

Në përgjigjen në padi të datës 19.07.2021 e paditura ka deklaruar se baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuese, kontestuese mbetet lartësia e saj pasi shuma e kërkuar nga paditësi bien ndesh me dëmin e shkaktuar. Sipas shkresave të lëndës vërtetohet se paditësi ka pësuar dëm material mbi këtë bazë dhe janë të gatshëm që palën e dëmtuar për 50% të përgjegjësisë ta kompensoj në shumën prej 829.50€.

Gjykata këtë aktvendim (që ka të bëjë me mbajtjen e seancës pa praninë e të paditurit) e ka bazuar në dispozitën e nenit 423 par.4, në të cilën përcaktohet se, nëse i padituri që është thirrur me rregull nuk vjen në seancën gjyqësore, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes mbahet pa praninë e tij.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqëse e zhvilloi procedurën e provave duke bërë administrimin e provave dhe atë: oferta e Ks Siguria datë 19.05.2021, ankesë datë 24.05.2021, fotografi, ekspertizë mbi vlerësimin e dëmit datë 08.07.2021, përgjigje në padi datë 19.07.2021 dhe parashtrësë mbi precizimin e padisë datë 26.10.2021.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lire, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Më datë 30.04.2021 paditësi kishte pësuar aksidenti me ç' rast vetuar e tij e tipit Nisan Almera ka pësuar dëm dhe e paditura nuk ia ka kompensuar këtë dëm material.

Se paditësi ka pësuar dëm në veturën e tij gjykata e vërtetoi në bazë të ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit e bërë me datë 08.07.2021 nga eksperti Msc.Sh.Y. i cili ka dhënë mendimin e tij edhe në seancën e datës 26.10.2021 i cili ka deklaruar se duke konstatuar se në bazë të shqyrtimi të përgjithshëm të materialit të prezantuar nga Gjykata Themelore Ferizaj, si dhe analizës gjithë përfshirëse të bazuar në kalkulim dhe të bazuar në katalogun Schwacke Liste, normativat e Bankës Qendrore të Kosovës për përcaktimin e vlerës së pjesëve të shpëtuara të automjetit Nissan Almera dhe atë : vlera e automjetit para aksidentit ka qenë 2022.0€; vlera e pjesëve të pa dëmtuara në automjet 362.0€, pra vlera e dëmit të shkaktuar në aksident është 1,662€

Gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarit të paditësit, i cili i propozoj gjykatës që ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se shumat e kërkuara si në precizim të kërkesëpadisë janë në harmoni me kriteret të cilat aplikohen nga kompanitë e sigurimit dhe praktika gjyqësore, sepse paditësi ka pësuar dëm material dhe lartësia e dëmit bazohet në ekspertizën e makinerisë, përgjegjëse për të cilën është e paditura dhe ka obligim të përmbushjes së detyrimeve dhe po ashtu shtoi se kërkesëpadia është në përputhje të plotë me dispozitat e LMD-së dhe se si e tillë duhet të miratohet në tërësi, e këtyre theksimeve gjykata ua dha besimin e plotë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të paditurës në përgjigje në padi, e cila deklaroi se baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuese por vetëm lartësia e saj, këto theksime gjykata mirëpo gjykata nuk ua fali besimin pasi këto pretendime e paditura ka pasur mundësi ti paraqes në seancën kryesore por e njëjta nuk ka prezantuar në seancë, gjithashtu sa i përket pretendimit se e paditura është e gatshme të kompensoj paditësin për 50 % të dëmit, nuk mund ti merr gjykata si pretendime serioze pasi e paditura nuk ka prezantuar prova për ndarje të përgjegjësisë, apo nxjerrjen e ekspertizës së komunikacionit, në mënyrë që të përcaktohet nëse në shkaktimin e aksidentit të datës 30.04.2021 kemi ndarje të përgjegjësisë. .

Nga sa u theksua më lart u vërtetua se paditësi si pasojë e dëmit të shkaktuar në aksidentin e cekur më lart, ka pësuar dëm material në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, nga baza e auto përgjegjësive respektivisht në mbështetje të nenit 19 të LSDA-së, si dhe duke u bazuar në nenin 136, nenin 173 par.1, 179 dhe neni 183 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën, meqenëse e paditura ka rënë në vonesë për kompensimin e dëmit paditësit, Gjykata në bazë të nenit 382 të LMD-së dhe bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës numër 265/2020 të datës 02.12.2020 bazuar në pjesën e dytë pika VI, ka vendosur që lartësia e kamatës të jetë 8%, ndërsa sa i përket llogaritjes së saj, nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi deri në pagesën definitive, është vendosur po ashtu bazuar po në këtë Mendim Juridik bazuar në Pjesën e Tretë pika XIV.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditëses të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 420€ edhe atë për një seancë gjyqësore 135€, për përpilimin e padisë 104€, për ekspertizë 150€ dhe për taksë gjyqësore 31€.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- DEPARTAMENTI CIVIL

C .nr.1278/21 prej dt.08.11.2021

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë përmes, kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.